



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborui Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.217/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Afijete Sada-Gllogjani dhe Kymete Kicaj anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Pokret Za Goru, me seli në Dragash, për shkak të vendosjes së posterëve në hapësira dhe ne objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa Anr.217/2019 e datës 04.10.2019 e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Pokret Za Goru, me seli në Dragash, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – vendosja e posterave në objekte publike, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1.100.00 € (një mijë e njëqind euro), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datë 04.10.2019, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se më datë 03.10.2019, rreth orës 13:01 janë parë disa materiale promovuese të subjektit politik Pokret Za Gora (PG) në afërsi të shkollës 9 Maji në Dragash, ku në këto materiale shihen kandidatet për deputet me numër 1,2,3,4,5,6 të kësaj partie. Parashtruesi i ankesës thekson se vendosja e materialeve promovuese është në kundërshtim me nenin 3 pika 3.4 e Rregullës Nr.13/2013, ku thekson se materialet e zgjedhjeve nuk duhet të vendosen brenda hapësirës së institucioneve publike, ose në objekte ne pronësi shtetërore.

Ankuesi si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një fotografi të posterit të kandidateve për deputet nga radhët subjektit politik, Pokret Za Goru të ngjitur në shtylla elektrike.

Në përgjigje në ankesë, të datës 04.10.2019, subjekti politik Pokret Za Goru thekson se lidhur me posterët e fotografuar afër shkollës 9 Maji, ju informojmë se posterët janë larguar menjëherë pasi që e kemi marr ankesën, pasi që posterët janë vendosur nga mosdija e aktivisteve të cilët kanë menduar se ndalesat vlejné vetëm gjate kohës së heshtjes zgjedhore

dhe në ditën e zgjedhjeve. Prandaj, të njëjtit theksojnë se ne momentin kur e kane parë gabimin e tyre, menjëherë i kane larguar posterët nga aty ku kane qenë të vendosura ato. Si dëshmi kane bashkangjitur fotografit duke i larguar posterët nga vendi ku kane qene te vendosura ato.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterët e kandidatëve për deputet nga subjekti politik Pokret Za Goru (PG), janë ngjitur në hapësirë publike, respektivisht në shtyllë elektrike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së, e cila dispozitë përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterëve dhe njoftimeve brenda ose jashtë hapësirave dhe objekteve publike, në apo mbi rrugët publike e tj*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjekti politik Pokret Za Goru (PG), është shkelur dispozita e lartë cekur ligjore, pasi që posterët e kandidatëve për deputet nga radhët e këtij koalicioni, janë vendosur në objektin publik përkatësisht në shtyllë elektrike e cila konsiderohet pronë publike dhe nuk është hapësirë e dedikuar për vendosje të posterëve.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik Pokret Za Goru (PG), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore.

Po ashtu si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, i'a dha mundësinë për tu përgjigjur në ankesë, dhe i njëjti ka deklaruar se janë marrë masa përmirësuese, ku është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografitë e bashkangjitura në përgjigje. Ndërmarrja e masave përmirësuese nga ana e subjektit në fjalë ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, sepse sipas nenit 3 paragrafi 2 i Rregullores së PZAP-it Nr. 01/2012, shkeljet e kësaj natyre të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mund te shqiptohet gjobë subjektit politik nga 5,100.00€ deri në 10,000.00€, mirëpo siç u konstatua më lart, veprimet e subjektit politik Pokret Za Goru (PG), për ta përmirësuar shkeljen, kanë ndikuar në uljen e lartësisë së gjobës.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 217/2019 më datën 05.10.2019

Kryesuesja e Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.